



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 134 Prot

Tiranë, më 25, 07, 2012

VENDIM Nr. 224, dt. 25.07.2012

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 25.07.2012, pasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, për Projektin: "Ndërtimi i HEC Shutina (Gjegjan, Pukë) mbi bazën e kërkesës së Subjektit "SHUTINA ENERGJI" sh.p.k., Mirditë,

VENDOSI:

- I. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" përgatitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentralit "HEC Shutina (Gjegjan, Pukë), paraqitur nga Subjekti "SHUTINA ENERGJI" sh.p.k., Mirditë.
- II. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike gjatë procesit të zbatimit, nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Dibër bazuar në kontratën dypalëshe midis "SHUTINA ENERGJI" sh.p.k. dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- III. Nëse pas fillimit të punimeve, zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjiko-etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë dhe investitori ("SHUTINA ENERGJI" sh.p.k.) duhet të njoftojë, brenda tri ditëve Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Dibër.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
ALDO BUMÇI

MINISTËR


SEKRETARI KKA
ROLAND OLLI



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al